

VENDIM
Nr.525, datë 30.7.2004

**PËR PROCEDURËN E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E LËNDËVE PLASËSE NË
REGJISTRIN SHTETËROR TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të regjistrit shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili të hapet dhe të mbahet në Ministrinë e Mbrojtjes.
 2. Çdo subjekt, që prodhon, eksporton dhe importon lëndë plasëse është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të aplikojë për regjistrimin e sasisë së këtyre lëndëve në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.
 3. Në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse regjistrohet edhe çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim, nga ana e prodhuesit dhe importuesit.
 4. Subjektet që aplikojnë janë të detyruara të paraqesin dokumentet e mëposhtme:
 - a) Fotokopje të noterizuar të lejes së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.
 - b) Adresën e saktë të personit juridik ose fizik (tel/fax, celular).
 - c) Proform-faturën nga uzina prodhuese, me llojin dhe sasi të lëndëve plasëse, për subjektet importuese.
 - ç) Dokumentin vërtetues të llojit, sasisë së lëndëve plasëse, për subjektet që prodhojnë dhe eksportojnë.
 - d) Dokumentet teknike, që i përkasin tipit të miratuar.
 - dh) Një kopje të certifikatës ekzaminuese, EC.
 5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

REGJISTRI SHTETËROR
I
REGJISTRIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Formati 390 x 265 cm

Nr. Emërtimit (kodit) _____ njësia e matjes _____ Çmimi _____

[illegible]

Nr. Emërtimit (kodit) _____ njësia e matjes _____ Çmimi _____

